

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare e kolegjit Agim Maliqi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit D.N, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga i dënuari, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj P.nr.123/2018 të datës 19.06.2018 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1nr.850/2018 të datës 30.10.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 19 dhjetor 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit D.N, anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj P.nr.123/2018 i datës 19.06.2018 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1nr.850/2018 i datës 30.10.2018 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj, me aktgjykimin P.nr.123/2018 e datës 19.06.2018, të dënuarin D.N e ka shpallur fajtor për veprën penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 të KPRK-së dhe e ka dënuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 21.11.2016 deri më datë 16.12.2016. Është obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej 20 € si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës penale në shumë prej 70 €, kurse

përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA.1nr.850/2018 e datës 30.10.2018, ka aprovuar pjesërisht si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe e ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale dhe vendimin për dënimin, ashtu që të dënuarin e ka shpallë fajtor për veprën penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim burgimi në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj. Ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë e ka refuzuar si të pabazuar, kurse në pjesët tjera aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ka mbetur i paprekur.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur i dënuari, për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshoj aktgjykimet e kundërshtuara dhe ti shqiptoj dënim sipas dispozitës së nenit 76 par.1 nënpar.1.5 të KPRK-së, pasi që me këtë dënim do të arrihej qëllimi i dënimit.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.238/2018 e datës 14.12.2018, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit, thekson se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë është shkelur ligjit penal, pasi që me rastin e matjes së dënimit si rrethanë rënduese gjykata e shkallës së parë ka gjetur pasojën e shkaktuar me rastin e kryerjes së kësaj vepre penale se në këtë aksident ka humbur jetën një fëmijë - nxënës duke u kthyer nga shkolla, ashtu që me këtë

rast elementin konstituiv të dispozitës ligjore e ka çmuar si rrethanë rënduese e të cilin arsyetim të gjykatës së shkallës së parë e ka pranuar edhe gjykata e shkallës së dytë.

Më tutje pretendohet se i dënuari ka bërë pranimin e fajësisë që në deklarinimin e tij në polici pastaj edhe në prokurori dhe gjatë shqyrtimit fillestar, me ç'rast ka ndihmuar gjykatën për procedimin efikas të kësaj çështje penale, andaj duke u bazuar në rrethanat lehtësuese theksohet se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë kanë shkelur dispozitën e nenit 76 par.1 nënpar.1.5 të KPRK-së me rastin e matjes së dënimit.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në pajtim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa gjeti se:

kërkesa është e bazuar.

Aktgjykimi i shkallës së parë, bazuar në referatin e paraqitur nga i dënuari, përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.12 të KPPK-së, meqë nuk është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 370 par.8 të KPPK-së edhe pse në kërkesë cilësohet si shkelje e ligjit penal.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar vetëm një rrethanë rënduese dhe atë pasojën e shkaktuar me rastin e kryerjes së kësaj vepre penale. Në arsyetim është theksuar se *“...si rrethanë rënduese gjykata gjeti pasojën e shkaktuar me rastin e kryerjes së kësaj vepre penale, ngase në aksident jetën e ka humbur një fëmijë-nxënë duke u kthyer nga shkolla i moshës 8 vjeçare.”*

Po ashtu edhe gjykata e shkallës së dytë në arsyetimin e aktgjykimit të saj vetëm konstaton rrethanat e theksuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe në këtë mënyrë të dy gjykatat kanë marrë si rrethanë rënduese elementin qenësor të veprës penale rrezikimi i trafikut publik e ndëshkueshme me dispozitën e nenit 378 par.9 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së dhe në këtë mënyrë arsyet për faktin vendimtar –lartësinë e dënimit janë të paqarta.

Duke vepruar kështu, aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje të dispozitës së procedurës penale nga neni 384 pa.1 nënpar.12 të KPPK-së e me këtë aktgjykimin e bën juridikisht të paqëndrueshëm.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe të marr një vendim të drejt dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike, ashtu që me rastin e vendimit për llojin dhe lartësinë e dënimit të jep arsye të qarta për rrethanat nga neni 74 të KPRK-së dhe të evitoj shkeljen në fjalë.

Nga këto arsye, kjo gjykatë konform nenit 438 par.1 pika 1.2 të KPPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.336/2018, më 19 dhjetor 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka